

UDHËZIM
Nr. 6/1, datë 17.3.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015 “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 40, të nenit 56 të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Pika 10 e nenit 51, ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“10. Kafshët për majmëri, importimi i të cilave është i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, në bazë të nenit 56, pika 40 e ligjit, janë:

-Kafshët e klasifikuara sipas kodit të NMK 0102 29 29.

-Larvat e peshkut të nënkreerëve nga 030 1 91 deri në 0301 99.

Në momentin e importimit të kafshëve të gjalla për majmëri, importuesi paraqet pranë ogranit doganor ku kryhen procedurat e zhdo-ganimit:

1. Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore se, ushtron aktivitet në fushën e bujqësisë dhe peshkimit.

2. Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë se, importuesi ka stabiliment të rritjes për majmëri të kafshëve të gjalla.

Për importin e larvave të peshkut, bëhet verifikimi nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë pranë degëve doganore kufitare. Inspektorët e Drejtorive Rajonale të Bujqësisë plotësojnë formularin tip i cili verifikon që produkti i importuar është larvë sipas kodeve tarifore të përcaktuara në këtë pikë.

Në datën 5 të çdo muaji, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i dërgon zyrtarisht Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve listën e importuesve të kafshëve të gjalla, sasi të dhe vlerën e kafshëve të gjalla për majmëri të importuara.”.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani